



UNIVERSITETI I PRISHTINËS FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 209 * Email: edukimi@uni-pr.edu * edukimi.uni-pr.edu

Abstrakt i zgjeruar

Titulli i Punimit:

NDIKIMI I METODËS SË DISKUTIMIT NË TË NXËNIT E NXËNËSVE TË KLASËS SË GJASHTË NË TEMËN BIODIVERSITETI

Autori:

Albiona Rudari

Mentori:

Prof.ass. Dr. Zenel Krasniqi

Programi:

Master i Mësimdhënies Lëndore, Mësimdhënia e Biologjisë

Viti akademik:

29.05.2026

Hyrja

Në Kosovë, edukimi mjedisor është pjesë e kurrikulës shkollore. Ndonjëherë edukimi mjedisor trajtohet në mënyrë të kufizuar dhe teorike, sidomos në arsimin fillor të mesëm të ulët. Mësimi i lëndëve shkencore si biologjia zakonisht realizohet me metodat tradicionale, ku nxënësi luan rol pasiv dhe përmbajtja trajtohet në mënyrë të fragmentuar. Një qasje e tillë e kufizon nxënësin në angazhim dhe kuptim të thelluar. Po ashtu, pengon zhvillimin e aftësive të mendimit kritik dhe vetëdijes mjedisore, të cilat janë aspekte thelbësore të edukimit mjedisor të këtij shekullit.

Tema Biodiversiteti si një komponent kyç i edukimit mjedisor, kërkon më shumë se thjesht njohuri faktike. Kjo temë kërkon përfshirje aktive të nxënësve, diskutime mbi problemet reale dhe zhvillim të ndjeshmërisë ndaj natyrës. Për këtë arsye kam zgjedhur të hulumtoj ndikimin e metodës së diskutimit në të nxënit e nxënësve të klasës së gjashtë, si një formë e mësimdhënies që inkurajon pjesëmarrje, bashkëpunim dhe reflektim të thelluar.

Qëllimi i studimit është të vlerësojë ndikimin e metodës së diskutimit në të nxënit e nxënësve të klasës së gjashtë në temën Biodiversiteti, si një komponent kyç i edukimit mjedisor dhe i qëllimeve të arsimit në Republikën e Kosovës.

Pyetja kryesore kërkimore është: Sa ndikon metoda e diskutimit në të nxënit e nxënësve të klasës së gjashtë në temën Biodiversiteti?

Hipoteza kryesore e studimit është: Nëse metoda e diskutimit zbatohet në procesin mësimor të nxënësve të klasës së gjashtë në temën Biodiversiteti, atëherë do të vërehet përmirësim i nivelit të njohurive dhe i të kuptuarit krahasuar me nxënësit që mësojnë me metodën tradicionale.

Metodologjia

Studimi bazohet në një qasje të kombinuar kërkimore (kuantitative dhe kualitative) me dizajn kuazi-eksperimental, i cili mundëson vlerësimin e ndikimit të metodës së diskutimit në kushte reale të mësimdhënies. Hulumtimi është realizuar me dy grupe paralele 6/1 dhe 6/2. Grupin eksperimental (6/2) në të cilin është zbatuar metoda e diskutimit, dhe grupin kontroll (6/1) në të cilin është përdorur metoda tradicionale. Mostra e studimit përbëhet nga 63 nxënës të klasës së gjashtë, 33 në grupin eksperimental dhe 30 në grupin kontroll, nga ShFMU “Dardania” në Prishtinë.

Instrumentet për mbledhjen e të dhënave kuantitative kanë qenë testi i njohurive paratesti dhe pastesti, të cilët kanë matur njohuritë dhe të kuptuarit e nxënësve mbi temën Biodiversiteti para dhe pas aplikimit praktik të metodës së diskutimit. Instrumenti tjetër ka qenë protokoll vëzhgimi, që përfaqëson pjesën kualitative të metodologjisë, përmes të cilit u analizua zbatimi i metodës së diskutimit në praktikën mësimore dhe efektiviteti i saj. Analiza kuantitative u krye përmes mesatares aritmetike, devijimit standard dhe t-testit, ndërsa të dhënat kualitative u analizuan në mënyrë përshkruese.

Rezultatet kryesore

Rezultatet e paratestit treguan se nuk kishte dallim statistikisht të rëndësishëm ndërmjet grupit kontroll dhe grupit eksperimental, çka dëshmon se të dy grupet kishin nivel të përafërt njohurish fillestare mbi biodiversitetin. Në pastest u evidentua një dallim i madh dhe statistikisht shumë domethënës në favor të grupit eksperimental. Nxënësit që mësuuan përmes metodës së diskutimit arritën mesatare dukshëm më të lartë krahasuar me grupin kontroll që mësoi me metodë tradicionale. Pikërisht t-test konfirmoi rëndësinë e këtij dallimi ($t = -14.342$; $p < .001$).

Rezultatet kualitative mbështetën gjetjet kuantitative. Vëzhgimet në klasë treguan se përdorimi i metodës së diskutimit rriti pjesëmarrjen aktive të nxënësve, nxitjen e mendimit kritik dhe kuptimin më të thelluar të koncepteve të biodiversitetit.

Diskutimi

Rezultatet e studimit konfirmojnë se metoda e diskutimit ka ndikim të dukshëm pozitiv në përvetësimin e njohurive dhe në kuptimin konceptual të biodiversitetit të nxënësit e klasës së gjashtë. Rritja e ndjeshme e rezultateve në grupin eksperimental tregon se të nxënit aktiv dhe ndërveprues është më efektiv se mësimdhënia tradicionale për temat e edukimit mjedisor.

Gjetjet janë në përputhje me studimet bashkëkohore mbi mësimdhënien me në qendër nxënësin, të cilat theksojnë se diskutimi nxit përpunimin aktiv të informacionit, mendimin kritik dhe pjesëmarrjen. Po ashtu, rezultatet mbështesin qasjen socio-kulturore të të nxënit, sipas së cilës ndërveprimi social dhe dialogu janë faktorë kyç në zhvillimin njohës të fëmijëve.

Rëndësia e gjetjeve qëndron në faktin se ato ofrojnë dëshmi empirike për efektivitetin e metodës së diskutimit në mësimdhënien e biologjisë dhe edukimit mjedisor në arsimin fillor të mesëm të ulët. Studimi tregon se integrimi sistematik i kësaj metode mund të përmirësojë arritjet akademike, të rrisë motivimin për të mësuar dhe të zhvillojë kompetenca.

Përfundimet dhe rekomandimet

Studimi konkludon se metoda e diskutimit ka ndikim pozitiv dhe statistikisht të rëndësishëm në të nxënit e nxënësve të klasës së gjashtë në temën Biodiversiteti. Nxënësit që mësojnë përmes diskutimit arrijnë nivel më të lartë njohurish, kuptim më të thelluar konceptual dhe pjesëmarrje më aktive në procesin mësimor krahasuar me nxënësit që mësojnë përmes metodës tradicionale.

Në bazë të gjetjeve, rekomandohet që metoda e diskutimit të integrohet më gjerësisht në praktikën mësimore të biologjisë dhe të edukimit mjedisor në arsimin fillor të mesëm të ulët. Mësimdhënësit duhet të trajnohen për përdorimin efektiv të metodave interaktive dhe për menaxhimin e diskutimeve në klasë.

Për hulumtime të ardhshme sugjerohet zgjerimi i studimit me mostra më të mëdha dhe në shkolla të ndryshme, si dhe analizimi i ndikimit afatgjatë të metodës së diskutimit në qëndrimet dhe sjelljet mjedisore të nxënësve.

Fjalë kyçe: *biodiversiteti, edukimi mjedisor, metoda e diskutimit, nxënësit e klasës së gjashtë.*

Extended abstract

Thesis Title:

THE IMPACT OF THE DISCUSSION METHOD ON SIXTH-GRADE STUDENTS' LEARNING IN THE TOPIC OF BIODIVERSITY

Author:

Albiona Rudari

Supervisor:

Prof. Ass. Dr. Zenel Krasniqi

Program:

Subject Teaching Master, Biology Teaching

Academic Year:

29.05.2026

Introduction

In Kosovo, environmental education is part of the school curriculum. However, it is sometimes addressed in a limited and theoretical way, especially in lower secondary education. The teaching of science subjects such as biology is usually conducted through traditional methods, where the student plays a passive role and the content is presented in a fragmented manner. Such an approach limits student engagement and deep understanding. It also hinders the development of critical thinking skills and environmental awareness, which are essential aspects of environmental education in this century.

The topic of Biodiversity, as a key component of environmental education, requires more than factual knowledge. It requires active student involvement, discussions on real-world issues, and the development of sensitivity toward nature. For this reason, this study investigates the impact of the discussion method on sixth-grade students' learning, as a teaching approach that encourages participation, collaboration, and deep reflection.

The purpose of the study is to evaluate the impact of the discussion method on sixth-grade students' learning in the topic of Biodiversity, as a key component of environmental education and educational goals in the Republic of Kosovo.

The main research question is: To what extent does the discussion method affect sixth-grade students' learning in the topic of Biodiversity?

The main hypothesis of the study is: If the discussion method is applied in the teaching process of sixth-grade students in the topic of Biodiversity, then an improvement in the level of knowledge and understanding will be observed compared to students taught through the traditional method.

Methodology

The study is based on a combined research approach (quantitative and qualitative) with a quasi-experimental design, which enables the evaluation of the impact of the discussion method in real teaching conditions. The research was conducted with two parallel classes, 6/1 and 6/2. The experimental group (6/2), in which the discussion method was applied, and the control group (6/1), in which the traditional method was used. The study sample consisted of 63 sixth-grade students, 33 in the experimental group and 30 in the control group, from the lower secondary school "Dardania" in Prishtina.

The instruments for quantitative data collection were the knowledge test (pre-test and post-test), which measured students' knowledge and understanding of the Biodiversity topic before and after the practical application of the discussion method. Another instrument was the observation protocol, representing the qualitative part of the methodology, through which the implementation of the discussion method in teaching practices and its effectiveness were analyzed. Quantitative analysis was conducted through arithmetic mean, standard deviation, and t-test, while qualitative data were analyzed descriptively.

Main Results

The pre-test results showed no statistically significant difference between the control and experimental groups, indicating that both groups had a similar initial level of knowledge about biodiversity. In the post-test, a large and highly statistically significant difference was found in favor of the experimental group. Students who learned through the discussion method achieved a significantly higher mean compared to the control group taught through the traditional method. The t-test confirmed the significance of this difference ($t = -14.342$; $p < .001$).

Qualitative results supported the quantitative findings. Classroom observations showed that the use of the discussion method increased students' active participation, stimulated critical thinking, and promoted deeper understanding of biodiversity concepts.

Discussion

The study results confirm that the discussion method has a clear positive impact on knowledge acquisition and conceptual understanding of biodiversity among sixth-grade students. The significant improvement in the experimental group indicates that active and interactive learning is more effective than traditional teaching for environmental education topics.

The findings are consistent with contemporary student-centered teaching studies, which emphasize that discussion promotes active information processing, critical thinking, and participation. Furthermore, the results support the socio-cultural learning approach, according to which social interaction and dialogue are key factors in children's cognitive development.

The significance of the findings lies in providing empirical evidence for the effectiveness of the discussion method in teaching biology and environmental education in lower secondary education. The study shows that systematic integration of this method can improve academic achievement, increase motivation for learning, and develop key competencies such as communication, collaboration, and critical thinking.

Conclusions and Recommendations

The study concludes that the discussion method has a positive and statistically significant impact on sixth-grade students' learning in the topic of Biodiversity. Students who learn through discussion achieve higher levels of knowledge, deeper conceptual understanding, and more active participation in the learning process compared to students taught through the traditional method.

Based on the findings, it is recommended that the discussion method be more widely integrated into biology and environmental education teaching practices in lower secondary education. Teachers should be trained in the effective use of interactive methods and in managing classroom discussions.

For future research, it is suggested to expand the study with larger samples and across different schools, as well as to analyze the long-term impact of the discussion method on students' environmental attitudes and behaviors.

Keywords: biodiversity, environmental education, discussion method, sixth-grade students.